

# Xhevdet SPAHIJA

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

# Mes ëndrrës dhe epshit

Pikturat e krijuesit Xhevdet Spahija qëndrojnë në mes bindjes përballë hijeshisë estetike të figuracionit nën kompozimin e hapësirë gjigante. Nga ana tjetër mund të vërejmë lëvizjen disi të unifikuar, të joshjes, të veprimit, të përformancës figurative ku në pëlhurë përveç që shohim ngjyrën, arrijmë të veçojmë përplasjen e formës nën gërshetimin e hapësirë, perspektivës, harmonisë dhe tonalitetit. Motivet në një farë forme janë në gjendje të qeta që japin shijimin e përkryer të kënaqësisë së vazhduar me shpagim të vërtetë të qenies njerëzore që qëndron në fitoren ndaj pengesave. Aktet veçohen për nga realizimi, kompozimi dhe qëndrojnë në pozita të ndryshme, disa janë të shtira, disa në lëvizje, të ulura, të shtrira në pozicione erotike që ndezin epshin. Janë të shkulura nga elementi më i natyrshëm, dhe ne si vëzhgues kemi nevojë të lodhemi së sodituri bukuritë paqetësuese dhe qetësuese saqë harrojmë vetveten dhe dhimbjen përvëluese të botës. Të gjitha kanë lindur nga dashuria, dashuria përdoret si lidhje ndërmjetësuese e veprës së artit. Ngjyrat si : bluja, grija, e kuqja, e verdha përvëluese, nxitin melodinë harmonike që krijojnë kozmosin ngjyror dhe konceptual. Mund të vërejmë edhe përkthimin e ëndrrave, diskutimin e brendshëm që buron nga instinkti i artistit. Ai veçon ngjyrën dhe figurën, por nuk lë anash as karakterin, kënaqësinë e prodhuar , nuk vë frenime për ta mbajtur peshoren në baraspeshë. Por, kompozicioni ka baraspeshë nëse analizohet në formë praktike, në atë shpirtërore ndjenja rrëmben penelin. Peizazhi, është mjaftë mjeshtëror, me blunë e ftohtë, arrin të përfundoj dikund thellë në perspektivë. Artisti nëpërmjet punimeve dukshëm na shpreh se pikënisja e çdo arti është dashuria, por nuk mungon as tragjedia, drama dhe ne fund besnikëria. Artisti na jep dashuri, rrezatim, kthim në një kohë tejet të rëndësishme, dhe na sfidon në mes bukurisë dhe shëmtisë, erotizmit dhe kënaqësisë së përjetshme. Në vepra vërehen konceptet, por edhe figurat, mirëpo të gjithë parapëlqejnë konceptet, këtu kemi një dyzim dhe përplasje në mes të dyjave, të unifikuara. Arti i tij arrin të na zbavitë dhe ajo që është efikase dhe që lë gjurmë, nuk është vetëm fryti i vullnetit, reflektimit, planifikimit, por gjestet, gjetjet e vogla dhe të mëdha, që kanë aftësi surreale fluturake, ashtu si në shumë vepra të njohura të cilat gjithnjë do të zgjojnë freski, hijeshi, ritëm, melodi nga të cilat zhvillohen dhe krijohen një varg temash. Në asnjë mënyrë, ai nuk lë mënjanë fuqinë e të kënaqurit dhe të kujtuarit, të cilat varen nga njëra tjetra. Kënaqësia shtrydhet nëpërmjet pëlhurës deri në pikën e fundit, i ngjanë një ëmbëlsie të frytit. Kujtimi i përket ruajtjes së kënaqësisë, origjinalitetit të ngjyrës, formës, tonit, kompozicionit dhe lëvizjeve të brushës.

Dr. Ilir Muharremi

05.09.2013
Prishtinë

# Shtator / September

2013



Pikturë në vaj  90 x 114 **Manon Lesko 2**



Pikturë në vaj 90 x 100 **Ekstazë në diell**



Pikturë në vaj 70 x 90 **Akti 2**



Pikturë në vaj 70 x 90 **Etja për jetë**



Pikturë në vaj  133 x 94 **Puthja e posedonit**



Pikturë në vaj 70 x 90 **Akti në natyrë**



Pikturë në vaj [illegible] x 40 **[illegible]**



Pikturë në vaj 90 x 100 **Torzo**



Pikturë në vaj  150 x 100 **Ekstazë**



Pikturë në vaj 100 x 90 **Pejsazh në detë**



Pikturë në vaj 100 x 80 **Xhelozia**



Pikturë në vaj 60 x 100 **Pejsazh nga Velipoja**



Pikturë në vaj 90 x 90 **I vetmuari**



Pikturë në vaj 90 x 100 **Pejsazh në lum**



Pikturë në vaj  90 x 100  **?????**



Pikturë në vaj  90 x 100 **Kompozicion**



Pikturë në vaj 80 x 100 **Torzo**



Pikturë në vaj 80 x 100 **Amori**



Pikturë në vaj 90 x 90 **Servantesi i Ulqinit**



Pikturë në vaj 90 x 90 **Njeriut të urt i mjafton një sy**



Pikturë në vaj 50 x 47 Pejsazh



Pikture ne vaj 46 x 55 **Pejsazh**



Fikture ne vaj 48 x 55 **Pejsazh**



Pikture ne vaj 80 x 60 **Pejsazh**



Pikturë në vaj 70 x 70 **Janusi**



Pikturë në vaj 65 x 80 **Larpetra**



Pikturë në vaj 60 x 50 **Pejsazh**



Pikturë në vaj [illegible] x 45 **Pejsazh**



Pikturë në vaj 80 x 60 **Pejsazh imagjinar**

# XHEVDET SPAHIJA

1950 u lind në Pejë (Kosovë)
1971 kreu shkollën e teknikëve të artit figurative – Pejë
1973 u diplomua në SHLP – Prishtinë në degën e artit figurative
1982 u diplomua në akademin e arteve në Prishtinë – dega e artit figurative
2005 kreu FA – studimet pasdiplonike dhe muarr granden Mr i pikturës

## EKSPOZITAT KOLEKTIVE

1971–1976 merrte pjesë në ekspozitat kolektive të shoqatës AF nëPejë
1976–1990 merrte pjesë në ekspozitat kolektive të shoqatës të AF në Gjakovë
1990–2009 merrë pjesë pothuajse në të gjitha ekspozitat kolektive të shoqatës AFAtëPejës
Merrë pjesë në ekspozitat e qershorit "DITA E PRISHTINËS" si dhe në festat e nëntorit që organizohen në kryeqytet.
Bionalet ndërkombëtare"Raciborz 2000 dhe 2002"në Poloni
Kolonit artistike "Jedretina 2001" në Zar të Kroacisë
Kolonit artistike në Velipoj 2007-2012 Shkodër -Shqipëri
2011 Në ekspozitën shitëse në mbështetje të "FONDACIONIT MBRETËRESHA SILVIA" në Hotel"Hilton"në Stokholm-Suedi
2012 Ekspozit e përbashkët për nder të figures së "Ali Ibër Nezës"në Gjakovë
2012 Ekspozita Kolegtive në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë për 100 vjetorin e shtetit Shqiptar

## EKSPOZITAT PERSONALE

2005 Ekspozita në Galerinë e Institutit Albanologjik në Prishtinë
2006 Ekspozita në Galerinë e Ministrisë së Kulturës - Prishtinë
2007 Ekspozita e përbashkët me ambasadorin e Greqisë Nicolaos Kanellos në Galerinë e Mullirit të"Haxhi Zekës"nëPejë
2009 Galerinë e Artit në Pejë
2009 në Pallatine Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë
2011 në Galerinë "Mitt i Centrum" në Geteborg të Suedisë
2012 në Biblotekën "Ibrahim Rugova" në Gjakovë
2012 në Galerinë e Ministrisë së Kulturë s– Prishtinë

MUZEU
HISTORIK KOMBËTAR

http://xhevdetspahija.weebly.com/

Katalogu
Teksti: Dr. Ilir Muharremi
Fotografitë:
Dizajni: Denis Spahija
U shtyp: Dukagjini

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje financiare nga:
Kuvendi Komunal Gjakovë,
shtypshkronja Dukagjini dhe
ETC.

dukagjini

ELKOS GROUP

